



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 11

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MF nr. 1, datë 8.1.2003	Për përjashtimin nga pagimi i taksave të drejtpërdrejta të veteranëve dhe invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, të invalidëve të punës si dhe të të verbërve.....	295
Udhëzim i MF nr. 2, datë 8.1.2003	Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë.....	296
Udhëzim i MF nr. 3, datë 27.1.2003	Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.....	307
Udhëzim i MF nr. 4, datë 27.1.2003	Për taksën vendore mbi biznesin e vogël.....	314
Udhëzim i MF dhe MPVD nr. 5, datë 27.1.2003	Mbi bashkëpunimin ndërmjet organeve tatimore qendrore dhe organeve të pushtetit vendor lidhur me administrimin e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.....	319

U D H Ë Z I M
Nr. 1, datë 8.1.2003

**PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGIMI I TAKSAVE TË DREJTPËRDREJTA TË
VETERANËVE DHE INVALIDËVE TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË
TË POPULLIT SHQIPTAR, TË INVALIDËVE TË PUNËS SI DHE TË TË VERBËRVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 8 të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, të nenit 13 të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të nenit 6 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit ", të nenit 4 të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërve", Ministri i Financave

U D H Ë Z O N:

1. Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, si dhe të verbërit përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta të parashikuara në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë".

2. Në kuptimin e përjashtimit nga taksat e drejtpërdrejta, konsiderohen taksa të drejtpërdrejta taksat e mëposhtme:

Taksa për shërbimet konsullore.

Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive.

c) Taksa për përdorimin e numrit telefonik kabllor.

d) Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë.

dh) Taksa për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion.

e) Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi.

f) Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti.

3. Përjashtimet nga taksat e drejtpërdrejta.

a) Përjashtimi nga taksa për shërbimet konsullore bëhet në rastet e pajisjes së veteranit të punës ose të luftës, invalidit të punës ose të verbërve me pasaportë.

b) Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, si dhe personat e verbër, kur këto pajisje janë në emrin e tyre.

c) Taksa për përdorimin e numrit telefonik kabllor. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës si dhe personat e verbër, kur abonimi telefonik është në emrin e tyre.

d) Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës ose personat e verbër në rastet kur dëshirojnë të vazhdojnë arsimin e lartë.

dh) Taksa e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës ose të luftës, veteranët e luftës, si dhe personat e verbër, kur kalojnë kufirin e Republikës së Shqipërisë me avion.

e) Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës ose të luftës, veteranët e luftës, si dhe personat e verbër, në rastet e pajisjes me pasaportë lundrimi.

f) Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës apo të luftës, veteranët e luftës, si dhe personat e verbër, në rastet e pajisjes me dëshmi aftësie për drejtim automjeti.

4. Sipas nenit 16/1 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", si dhe të nenit 4 të ligjit 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" kur invalidi i punës dhe personi i verbër ushtrojnë veprimtari private, nuk përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta.

5. Përjashtimi nga pagimi i taksave të mësipërme bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, invalidit të punës ose të luftës si dhe të verbërit.

6. Veterani i luftës, invalidi i luftës ose i punës, si dhe personat e verbër duhet të paraqesin pranë agentit tatimor, librezën e veteranit, invalidit të punës ose të luftës, si dhe librezën e të verbërit

së bashku me dokumentin që e ka pajisur dega e tatimeve të rrethit për përjashtimin nga këto taksa.

7. Të gjitha përjashtimet do të shënohen në një regjistër të veçantë ku do të jetë shënuar emri, mbiemri, si dhe ekstremet e librezës.

MINISTRI I FINANCËVE
KASTRIOT ISLAMI

U D H Ë Z I M
Nr. 2, datë 8.1.2003

PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 74 të ligjit nr. 8860, datë 22.12.1999, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatim të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", Ministria e Financave

U D H Ë Z O N:

Dispozita të Përgjithshme

Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002, taksat kombëtare derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit .

Taksat vjetore arkëtohen nga agjentët e taksave brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Kur detyrimi për herë të parë lind në fillim të vitit, taksat paguhet në masën 100%, ndërsa kur detyrimi i vjeljes së taksave për herë të parë lind 6 mujorin e dytë, paguhet 50% e masës së taksës së përcaktuar në ligj. Në kuptimin e detyrimit të vjeljes së taksave vjetore për herë të parë kuptojmë:

Shembull: Për vjeljen e taksës së tonazhit për aks të mjeteve, kur një mjet regjistrohet dhe paguan taksën e tonazhit për aks për herë të parë në drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor 6 mujorin e parë, ai paguan 100% të taksës, ndërsa kur mjeti regjistrohet 6 mujorin e dytë, ai paguan 50 % të taksës. Për vitet në vazhdim kjo taksë do të paguhet në fillim të tremujorit të parë në masën 100%.

Në zbatim të nenit 9, agjentët e taksave të përcaktuar në nenin 6 të ligjit, përfitojnë një përqindje të caktuar të arkëtimeve nga taksat. Punonjësit e taksave në degët e tatimeve në rrethe bëjnë aktraktordime me agjentët e taksave për taksat e vjela, si dhe përcaktojnë shumën që u takon agjentëve të taksave. Aktin e rakordimit, i cili do të jetë i firmosur nga inspektori i taksave, përfaqësuesi i agjentit të taksave si dhe nga Kryetari i Degës së Tatimeve, agjentët e taksave duhet ta paraqesin në degën e thesarit të rrethit ku ushtrojnë aktivitetin e vjeljes së taksave.

Kriteret e përdorimit të komisioneve që ju jepen agjentëve të taksave janë përcaktuar në ligj dhe përdoren për shpërblime të punonjesve që merren me vjeljen e taksave. Drejtuesi i agjentit të taksave cakton punonjësit që merren me vjeljen e taksave. Këta punonjës përgjigjen për vjeljen dhe arkëtimin e taksave sipas ligjit.

Gjithashtu komisionet përdoren edhe për përballimin e shpenzimeve të vjeljes së taksave si shtypshkrime, komisione bankare etj).

Në zbatim të nenit 6 të ligjit agjentët e taksave janë të detyruar të bëjnë vjeljen e taksave dhe të derdhin në buxhet shumat e vjela sipas ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Dispozita të veçanta

Sipas llojit të taksave:

1. Taksat portuale

Ngarkohen me vjeljen e këtyre taksave kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare shtetërore ose private.

Taksat portuale paguhen nga anijet shqiptare ose të huaja sa herë prekin portet e Republikës së Shqipërisë për veprime tregtare në bazë të nivelit të taksave, të përcaktuara në lidhjen nr.1 të ligjit "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë".

Konsiderohen veprime tregtare dhe jotregtare veprimet të cilat janë përcaktuar në nenin 5 të ligjit.

Taksat portuale paguhen me mbërritjen e anijes dhe janë të vlefshme gjatë gjithë kohës që anija qëndron në port.

Taksat portuale paguhen në secilin port të Shqipërisë pavarësisht nëse anija mbërrin nga jashtë ose nga një port tjetër i shtetit shqiptar.

Pagesat e taksave nga anijet tregtare të huaja bëhen me euro. Për anijet e personave juridikë apo fizikë shqiptarë, shtetërorë ose private, taksat llogariten dhe paguhen në lekë ose valutë, duke u konvertuar me kursin e bankës.

Anije të subjekteve shqiptare do të konsiderohen anijet që janë në pronësi të vet dhe anijet e marra me qira.

Të gjitha përjashtimet nga pagesat e taksave portuale të parashikuara në këtë ligj do të regjistrohen në regjistër.

2. Taksat për shërbimet konsullore

Ngarkohen me vjeljen e kësaj takse Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Rendit Publik. Shtetasit që pajisen me pasaportë për dalje jashtë shtetit, përveç pagimit të vlerës së pasaportës, do të paguajnë dhe taksën e përcaktuar në pikat 1, 2 të lidhjes nr. 2 "Taksat për shërbimet konsullore".

Për shërbimet që kryhen nga përfaqësitë tona diplomatike në vende të tjera, pagesat e taksave bëhen në euro siç janë përcaktuar në lidhjen nr. 2 "Për taksat për shërbimet konsullore". Nga ana e Ministrisë së Jashtme, çdo muaj do të derdhet në degën e thesarit Tiranë shuma e taksave konsullore të arkëtuara nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë shtetit. Dega e thesarit, pasi bën rakordimet e nevojshme me Ministrinë e Jashtme, në fund të çdo muaji, shumën e taksave konsullore e derdh në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Me termin përfaqësi, kuptohet përfaqësia diplomatike ose konsullore e Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit.

Taksa nga përfaqësitë mund të arkëtohet edhe në monedhën e vendit të konvertuar me kursin e këmbimit në euro në momentin e derdhjes së taksës.

Taksat për veprimet konsullore arkëtohen me fillimin e procedurës përkatëse.

Institucionet shtetërore që do të presin shtetas të huaj, të cilët janë të përjashtuar nga pagesa e taksës së vizës ose të hyrjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, u konfirmojnë pikave të kalimit të kufirit, emrat e personave të cilët janë të përjashtuar. Konfirmimi për këtë qëllim jepet vetëm nga titullari i institucionit shtetëror.

Ministria e Jashtme i dërgon Ministrisë së Rendit Publik, listën e taksës së vizës dhe të hyrjes. Ministria e Rendit Publik dërgon në PKPK listën e taksës së vizës ose të hyrjes.

Procedura e pagimit të taksës së hyrjes dhe të vizës

Taksa e hyrjes ose taksa e vizës paguhet në euro ose valutë tjetër lirisht të konvertueshme.

Me vjeljen e taksës së hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë ngarkohen PKPK.

Me vjeljen e taksës së vizës ngarkohen përfaqësitë. Në rastet kur viza jepet në kufi, taksa e vizës arkëtohet nga PKPK mbi bazën e konfirmimit nga dega e vizave në Ministrinë e Rendit Publik.

Vjelja e taksës së hyrjes ose të vizës në PKPK dokumentohet me mandatarkëtimi, i cili duhet të përmbajë, veç shënimeve standarde edhe shtetësinë e paguesit, numrin rendor të regjistrimit të hyrjes së shtetasve të huaj, llojin e monedhës që derdh i huaji. Mandati i arkëtimit përpilohet nga kontrolli i shërbimit të PKPK në dy kopje, njërën nga të cilat ia jep qytetarit të huaj dhe tjetrën e mban vetë. Në dalje të PKPK vendoset një kontroll i dytë i policisë kufitare që kontrollon nëse është bërë pagesa ose jo.

Në aeroportin e Rinasit mandatarkëtimi dhe vjelja e valutës bëhen nga arkëtarja e policisë kufitare.

Për regjistrimin dhe kontrollin e mjeteve monetare në arkë kontrollori i shërbimit (arkëtarja në ato pika kalimi kufitar ku është vendosur arkëtar) të gjitha mandatarkëtimet i regjistron në librin e arkës sipas numrit kronologjik rritës për secilën lloj monedhe. Libri i arkës nënshkruhet për çdo datë nga komandanti ose kryekontrollori i PKPK.

Të ardhurat e realizuara nga vjelja e taksave derdhen menjëherë në llogarinë e Degës së Tatimeve dhe Taksave në rrethet ku ka PKPK nga kontrolli përkatës ose nga arkëtarja në ato PKPK ku ka arkëtare.

3. Taksa vjetore e tonazhit të mjeteve për aks

Taksa e tonazhit për aks arkëtohet brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Kjo llogaritet sipas lidhjes nr. 3 të ligjit "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë". Theksojmë se në lidhje është përcaktuar masa e taksës për një aks dhe kjo taksë duhet të shumëzohet me numrin e akseve që ka mjeti. Zotëruesi i mjetit pajiset nga drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor me një dokument që vërteton pagesën e kësaj takse si dhe me pullën e taksës, të cilën zotëruesi i mjetit është i detyruar ta vendosë në xhamim e përparmë të mjetit. Këto dokumente duhet të përmbajnë elemente të sigurisë së lartë për të shmangur falsifikimin.

Drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk do të bëjnë kontrollin teknik të mjeteve në rastet kur zotëruesi i mjetit nuk ka paguar taksën e tonazhit për aks.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të ndjekin në vazhdimësi vjeljen e këtyre taksave duke ushtruar kontrolle të vazhdueshme në pikat rrugore.

Drejtoria e Qarkullimit Rrugor pranë Ministrisë së Rendit Publik, nëpërmjet degëve të qarkullimit rrugor në rrethe, bën kontrollin e vjeljes së taksës së tonazhit për aks të mjeteve.

Punonjësit e taksave në degët e tatimeve në rrethe bëjnë aktrakordime me punonjësit e drejtorive rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor në rrethe dhe punonjësit e degëve të qarkullimit rrugor në rrethe për taksat e vjela, ku përcaktojnë edhe shumën që u takon drejtorive rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe degëve të qarkullimit rrugor. Ky akt dorëzohet në degën e thesarit të rrethit ku ushtrojnë aktivitetin e vjeljes së taksave, edhe çdo muaj, por gjithmonë brenda vitit kalendarik.

Në zbatim të ligjit, përjashtohen nga taksa e tonazhit për aks mjetet në pronësi të personave fizikë e juridikë, të cilët deklarojnë se gjatë vitit vijues kalendarik nuk do të punojnë dhe për këtë zotëruesi i mjetit duhet që brenda muajit janar të dorëzojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në drejtorinë rajonale të rrethit ku është regjistruar mjeti), targën dhe lejen e qarkullimit.

Drejtoria rajonale verifikon pagesat e taksave të viteve të mëparshme, si dhe të gjitha detyrimet që mund të ketë dhe mbas pagesës së detyrimeve jep të drejtën e përjashtimit. Të gjitha përjashtimet duhet të shënohen në një regjistër të veçantë.

4. Taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët e doganave në pikat e kalimit kufitar. Shtetasit e huaj në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjete me targë të huaj, pajisen nga degët e doganave me një vërtetim hyrjeje sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ky vërtetim duhet të jetë me numër serial dhe të mbahet në dy kopje, nga e cila njëra do t'i jepet personit që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjet me targë të huaj, ndërsa kopja tjetër do të ruhet në degët e doganave. Ky vërtetim është i detyrueshëm të paraqitet në degën e doganës në pikën e kalimit kufitar në dalje, me qëllim që degët e doganave të llogarisin dhe arkëtojnë taksën e qarkullimit të automjetit me targë të huaj dhe të arkëtojnë taksën për ditët e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo pagesë do të bëhet me mandatarkëtime, nga të cilat një kopje i jepet taksapaguesit, kopja tjetër i bashkëngjitet vërtetimit që paraqet shtetasi i huaj në dalje dhe ruhet në degën e doganës.

Për rastet kur automjeti me targë të huaj, me anën e aktit noterial kalon në pronësi të personave të tjerë dhe do të pajiset me targë shqiptare, pronari duhet t'i paraqesë degës së doganës në momentin e zhdoganimit të automjetit, dhe vërtetimin e hyrjes që i është dhënë shtetasit të huaj në pikën e kontroll kalimit kufitar në hyrje, me qëllim që të llogaritet edhe taksa e qarkullimit të automjetit për ditët e qëndrimit.

Degët e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk do të bëjnë pajisjen me targa shqiptare, si dhe regjistrimin e mjetit pa u paguar detyrimet e taksës së qarkullimit të automjeteve të huaja.

Të gjitha taksat e arkëtuara mbahen në një regjistër të veçantë nga degët e doganave në pikat e kalimit kufitar, ku shënohet lloji i mjetit, ditët e qëndrimit si dhe shuma e taksës së paguar.

Në zbatim të nenit 10 të ligjit, përfituesit e përjashtimeve nga pagimi i kësaj takse do të

paraqesin pranë degës së tatimeve të rrethit ku ushtrojnë aktivitetin e tyre një kërkesë ku të jenë përcaktuar automjetet me targë të huaj sipas tipeve, numrin e shasisë, motorit si dhe targën përkatëse. Pas paraqitjes së dokumenteve, degët e tatimeve duhet t'i pajisin ato me dokument sipas modelit bashkëngjitur ku të shënohet automjeti sipas tipit, numrit të shasisë e motorit, targa dhe periudha e perjashtimit.

Me paraqitjen e vërtetimeve të lëshuara nga degët e tatimeve, degët e doganave në hyrje do të lëshojnë një vërtetim të veçantë me numër serial të bashkëngjitur në dy kopje, një prej të cilëve i jepet zotëruesit të mjetit, ndërsa kopja tjetër ruhet në degën e doganës.

Në dalje të mjetit me targë të huaj nga territori i Republikës së Shqipërisë, degët e doganave detyrohen t'u marrin zotëruesve të mjeteve të firmave të përbashkëta ose të huaja kopjen e vërtetimit që iu është dhënë në momentin e hyrjes në territorin shqiptar dhe t'i regjistrojë këto vërtetime në një regjistër të veçantë.

5. Taksë e importimit të automjeteve të përdorura

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët e doganave dhe paguhet nga importuesi i automjetit në momentin e zhdoganimit të automjetit.

Degët e doganave bëjnë llogaritjen e taksës. Llogaritja e kësaj takse është e diferencuar sipas vitit të prodhimit, llojit të automjetit.

Degët e doganave të gjitha arkëtimet nga taksat i regjistrojnë në një regjistër të veçantë ku shënojnë llojin e mjetit sipas përcaktimit të bërë në ligjin për sistemin e taksave, emrin e zotëruesit të mjetit, vitin e prodhimit si dhe shumën e taksës.

6. Taksa e pajisjes me lejedrejtim për drejtim automjeti

Taksa për pajisjen me lejedrejtim për drejtim automjeti arkëtohet nga drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Detyrimi i pagimit të kësaj takse lind në momentin e dhënies së dëshmisë së aftësisë për drejtim automjeti. Shtetasi duhet të pajiset me dokumentin që vërteton pagimin e kësaj takse.

Të gjitha pagesat e taksës do të regjistrohen në një regjistër të veçantë. Në regjistër do të shënohet emri, mbiemri i personit që pajiset me dëshmi për drejtim automjeti, grupi përkatës i dëshmisë së aftësisë dhe masa e taksës së paguar.

7. Taksa e përdorimit të aparateve radiotelevizive

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen zyrat e pagesës së energjisë elektrike dhe vjelja e kësaj takse duhet të bëhet brenda tremujorit të parë.

Kjo taksë paguhet për marrësit radiofonikë dhe televizivë individualë që janë në gjendje teknike të marrin programe të radios ose të televizionit.

Për çdo familje merret në konsideratë vetëm një marrës i çdo lloji. Kur familjet kanë vetëm marrës radio, ato do të paguajnë vetëm taksën për radion. Për këtë ato duhet të njoftojnë në degën e tatimeve të rrethit ku banojnë, e cila do të verifikojë nëse ka vetëm aparat televiziv dhe i jep vërtetimin me firmën e kryetarit të degës. Kur familja ka vetëm marrës televiziv do të ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e marrësit radiofonik.

Personat fizikë e juridikë do të paguajnë taksën për përdorimin e aparaturave radio televizive për të gjitha aparaturat që disponojnë në ambientet e tyre.

Degët e tatimeve në rrethe të bashkëpunojnë me zyrat e pagesës së energjisë elektrike, për njoftimin dhe pagimin nga ana e zotëruesve të taksës së aparateve radiotelevizive të taksave.

Pagesat e taksës do të vërtetohen për përdoruesit në librezën e pagesës së energjisë elektrike ku do të shënohet "Paguat taksa për vitin _____, data e pagesës si dhe firma dhe vula e punonjësit të ngarkuar me vjeljen e kësaj takse.

Këto taksa do të shënohen në një regjistër të veçantë, ku të shënohen të gjithë taksa paguesit, shuma e pagesës dhe data kur është kryer pagesa.

8. Taksa e përdorimit të numrit telefonik

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen operatorët përkatës të numrit telefonik dhe paguhet brenda tremujorit të parë të çdo viti. Pagesa e kryer do të vërtetohet në librezën e pagesës së telefonit për telefonat kabllorë, ku do të shënohet "paguar taksa e telefonit për vitin _____, si dhe firma e punonjësit të ngarkuar për vjeljen e kësaj takse dhe vula.

Për telefoninë celulare pagesa e taksave të zotëruesve të aparateve celulare bëhet nga operatorët celularë, të cilet janë përgjegjës për vjeljen e taksave. Degët e tatimeve bëjnë çdo muaj rakordimet për numrat celularë të shitur, si dhe kontrollin e derdhjes së taksave.

9. Taksa për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, prokurorisë, noteria dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme

Me vjeljen e këtyre taksave ngarkohen Ministria e Drejtësisë, organet gjyqësore, prokuroria, zyrat e noterisë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Këto taksa paguhet në momentin e kryerjes së veprimeve sipas lidhjes nr. 5 të ligjit dhe bëhen me anën e pullës ose me mandatarkëtim për ato raste kur kjo taksë nuk vilet me anën e pullës. Pullat e taksave vendosen në çdo kopje të dokumentit të lëshuar për të gjitha dokumentet që sipas ligjit duhet të pajisen me pulla takse. Dokumentet janë të vlefshme, kur pulla e taksës është e vulosur nga organi që kryen shërbimin. Për plotësimin e vlerës së pullës për aktet që leshohen mund të përdoren një ose më shumë pulla, me kusht që ato të përmbajnë vlerën sa është masa e taksës.

Në rast se personi do të kërkojë kopje të akteve apo dokumenteve të lëshuara nga organet gjyqësore noteriale, vlera e pullës së taksës është përcaktuar në lidhjen nr. 5 të ligjit, me kusht që tek akti ose dokumenti të jetë shënuar fjala "kopje". Në rast të kundërt do të merret vlera e plotë e taksës.

Taksa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore, noteriale.

10. Taksa e regjistrimit në arsimin e lartë

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen universitetet dhe shkollat e tjera të larta dhe arkëtohen në momentin e fillimit të vitit të ri shkollor, për çdo vit arsimor.

Pagesat e taksave regjistrohen në regjistër dhe derdhen në llogarinë e Degës së Tatimeve.

11. Taksa për shërbimet e radiokomunikacioneve

Me vjeljen e këtyre taksave ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT). Llogaritjet teknike të taksave bëhen nga ERT-ja sipas lidhjes nr. 6. ERT-ja nuk u jep licencë subjekteve fizikë ose juridikë për përdorimin e sistemeve të radiokomunikimit pa vjelë taksat.

ERT-ja njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për rastet kur subjektet nuk rinovojnë licencat si dhe në rastet e identifikimit të përdorimit abuziv të spektrit të frekuencave dhe bashkëpunojnë së bashku për shmangjen e evazionit fiskal në këtë fushë.

Të gjitha taksat e vjela do të regjistrohen në një regjistër të veçantë.

12. Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit (KKRT). Llogaritjet teknike të taksës bëhen nga KKRT-ja sipas lidhjes nr. 9 të ligjit.

KKRT-ja njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kur subjektet nuk paguajnë taksën vjetore të shërbimeve të transmetimeve radiotelevizive, kur nuk rinovojnë licencat, si dhe në rastet e identifikimit të transmetimeve të palicencuara.

Të gjitha këto taksa arkëtohen menjëherë në Buxhetin e Shtetit dhe evidentohen nga KKRT-ja në një regjistër të veçantë.

13. Taksa e kalimit me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet dega e doganës Rinas. Kjo taksë do të arkëtohet nëpërmjet biletës së taksës të cilat janë me numër serial. Çdo shtetas i huaj apo shqiptar është i detyruar të paguajë taksën me paraqitjen e biletës së udhëtimit me avion. Dega e doganës Rinas pajis shtetasin me biletën e taksës që i bashkëngjitet biletës së avionit. Kjo biletë vuloset nga ana e degës së doganës Rinas duke shënuar datën dhe orën e udhëtimit.

Të gjithë personat, që në bazë të ligjit përjashtohen nga pagimi i taksës së kalimit të kufirit me avion, do të pajisen me një vërtetim me numër serial të firmosur nga kryetari i degës së doganës. Ky vërtetim do të jetë në dy kopje, njëra do të mbetet në degën e doganës. Të gjitha përjashtimet do të regjistrohen në një regjistër të veçantë ku të shënohet emri, mbiemri i personit, numri i pasaportës, data dhe orari i fluturimit.

Të gjithë shtetasit e huaj a vendas janë të detyruar të ruajnë biletën e taksës dhe vërtetimin e përjashtimit nga pagesa e taksës.

Në fund të ditës do të bëhet rakordimi i Degës së Doganës Rinas me PKPK Rinas dhe agjencive ajrore.

Pagesa e taksës përballohet nga vetë shtetasit shqiptarë apo të huaj. Për rastet kur shtetasit shkojnë me shërbim jashtë atdheut pagesa e taksës përballohet nga institucioni që e dërgon me shërbim. Shtetasit paguajnë në doganë taksën e kalimit të kufirit me avion dhe me paraqitjen e biletës së taksës institucioni është i detyruar të bëjë rimbursimin e saj.

Arkëtimet e çdo dite do të regjistrohen në një regjister të veçantë dhe do të derdhen menjëherë në llogarinë e degës së tatimeve.

14. Taksa e pajisjes se personave me pasaportë lundrimi

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet kapiteneria e porteve. Pasaporta e lundrimit është dokument identifikimi i pjesëtarëve të ekuipazheve të anijes ose personave të tjerë që mund të punojnë dhe udhëtojnë me këto anije. Kjo taksë derdhet menjëherë në llogarinë e degës së tatimeve. Kapiteneria e porteve i regjistron në një regjistër të veçantë të gjitha pasaportat e lundrimit që janë lëshuar duke shënuar, emrin, mbiemrin e punonjësit që i jepet pasaporta e lundrimit.

15. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit

Kjo taksë është vjetore dhe me vjeljen e saj ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Peshkimit.

Pagesat e kësaj takse bëhen sipas lidhjes nr. 7 të ligjit. Detyrimi për pagimin e kësaj takse lind në momentin e marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit. Drejtoria e Peshkimit i regjistron në një regjistër të veçantë të gjitha lejet e dhëna ku të përcaktohet subjekti që merr lejen, data, lloji i gjuetisë së peshkimit, tipi i mjetit dhe masa e taksës së paguar. Lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit do të jepen pasi të jetë paguar taksa përkatëse.

16. Taksa e akteve dhe e pullës

Vjelja e këtyre taksave bëhet nga zyrat e gjëndjes civile. Shtetasit, për çdo dokument të lëshuar nga zyrat e gjëndjes civile, janë të detyruar të paguajnë taksën sipas lidhjes nr. 5 të ligjit. Dokumentet e gjëndjes civile janë të vlefshme vetëm kur kanë pullën e taksës të vulosur me vulën e gjëndjes civile.

Shtetasit shqiptarë, që pajisen me pasaportë, do të paguajnë, përveç vlerës së pasaportës, edhe taksën. Vjelja e kësaj takse do të bëhet me mandatarkëtimin dhe kjo pagesë do të shënohet në një regjistër të veçantë.

17. Taksa për uljengritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport

Vjelja e kësaj takse bëhet nga Albtransporti. Pagesat e taksave do të bëhen në valutë sipas lidhjes nr. 8 bashkëngjitur ligjit. Arkëtimet e taksave aeroportuale do të regjistrohen në një regjistër të veçantë, ku të regjistrohen të gjithë fluturimet e avionëve, lloji i avionit, pesha e tij dhe masa e taksës së vjelë dhe do të derdhen në llogarinë e buxhetit të shtetit (Dega e Tatimeve Tiranë).

18. Taksa për mbikalimet ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil (DPAC), nëpërmjet Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA). Të ardhurat nga kjo taksë arkëtohen në valutë dhe transferohen në llogarinë e Buxhetit të Shtetit (Dega e Tatimeve Tiranë).

Për të gjithë avionët, që përjashtohen nga pagimi i taksave aeroportuale, DPAC-ja do të dërgojë pranë ndërmarrjeve të saj urdhrin me shkrim, për avionët që përjashtohen sipas ligjit. Përjashtimet do të regjistrohen në një regjistër të veçantë.

19. Taksa e rentës minerare

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët e tatimeve dhe taksave në rrethe. Leja për shfrytëzimin e pasurisë minerare jepet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Zotëuesi i lejes duhet të regjistrohet në organet tatimore dhe brenda datës 15 të muajit pasardhës duhet të derdhë për llogari të degës së tatimeve dhe taksave, ku ushtron aktivitetin e tij, taksën e rentës së pasurisë të specifikuar në nenet 51, 74 dhe 83 të ligjit mineral, sipas vlerës së tregut të mineraleve të shitura konsumatorëve gjatë muajit.

Për të përcaktuar vlerën e tregut të këtyre mineraleve, me qëllim që të llogaritet renta e pasurisë minerare, veprohet si vijon:

1. Vlera e tregut të mineralit të shitur tek konsumatori gjatë muajit kalendarik jepet:

a) Në rastin kur produkti i shitur është mineral i nxjerrë nga miniera, vlera e tregut të mineralit është e barabarte me çmimin e shitjes së produktit.

b) Në rastin kur produkti përfundimtar i shitur është përpunuar më tej, vlera e tregut të mineralit është e barabartë me çmimin e shitjes së produktit përfundimtar gjatë muajit kalendarik, minus:

b.1. shpenzimet e pasurimit, shkrirjes dhe të rafinimit që janë kryer mbi mineralin;

b.2. shpenzimet e transportit nga miniera në fabrikën e pasurimit, shkritore ose impiantet e rafinimit të mineralit;

b.3. të gjitha shpenzimet e tjera të cilat nuk janë zbritur në pikën 1 dhe që lidhen me koston e pasurimit, shkrirjes ose rafinimit.

2. Çmimi i shitjes nënkupton:

2.1 Në qoftë se produkti eksportohet, çmimi i shitjes është F.O.B. Shqipëri.

2.2 Në qoftë se produkti nuk eksportohet, çmimi i shitjes është i barabartë me çmimin e shitjes në Shqipëri, minus:

- shpenzimet e transportit të produktit nga pika e prodhimit deri në pikën e shitjes F.O.B Shqipëri

- shpenzimet e tjera të shitjes, nëse ka të tilla.

Zotëruesi i lejes duhet të dorëzojë brenda datës 5 të muajit këto të dhëna:

a) emrin dhe përshkrimin e mineralit;

b) emrin dhe adresën e zotëruesit të lejes dhe administratorit;

c) sasinë e mineralit të prodhuar gjatë muajit të kaluar;

d) një konfirmim lidhur me prodhimin e muajit të kaluar dhe shpërndarjen e tij (psh. tek konsumatorët, fabrikat e pasurimit, shkretoret, rafineritë ose të depozituar);

e) sasinë e mineralit të shitur tek konsumatorët gjatë muajit kalendarik, emrat dhe adresat e blerësve dhe kontratat e shitjes, të cilat duhet të përmbajnë veçoritë mbi natyrën, cilësinë dhe përmbajtjen e mineraleve;

f) emrat dhe vendndodhjet e fabrikave të pasurimit, shkretoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali;

g) koston për ton të fabrikës së pasurimit, shkretoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali gjatë muajit kalendarik;

h) koston për ton të transportit të mineralit të shitur gjatë muajit kalendarik e detajuar kjo në rastin kur transporti i mineralit kryhet duke kaluar në disa hallka transporti.

i) shpenzimet e shitjes, nëse ka dhe që janë kryer gjatë muajit kalendarik;

j) një llogaritje të detajuar të rentës së pasurisë minerare gjatë muajit kalendarik.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të mbajë pranë minierës librat përkatës të prodhimit të mineralit nga zona e lejuar dhe të gjithë dokumentacionin që lidhet me to. Të gjitha të dhënat mbi prodhimin, transportin, përpunimin dhe shitjen, përfshirë këtu dhe kontratat e shitjes, kontrollohen nga degët e tatimeve dhe taksave.

20. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme (automjetet)

Për vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kjo taksë aplikohet për çdo ndryshim të pronësisë së mjeteve.

Taksa e kalimit të pronësisë vilet në momentin, kur dokumenti i kalimit të pronësisë (me aktin noterial të shitjes, dhurimit, e të tjera të ngjashme me to) paraqitet për veprim në zyrat e regjistrimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për pajisjen me lejen e re të qarkullimit të mjetit. Pronari i ri, përveç dokumentacionit të domosdoshëm që duhet për të legalizuar kalimin e të drejtës së pronësisë, paraqet edhe kopje të noterizuar të kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

Të gjithë pronarët e mjeteve, kur bëjnë kalim të pronësisë së mjetit paguajnë taksën e kalimit të pronësisë:

- në masën 2% të vlerës së kalimit të pronësisë të shprehur në kontratë, duke marrë për bazë edhe vitin e prodhimit.

Drejtoritë rajonale pasi llogarisin shumën e taksës konform ligjit, të gjitha veprimet e takses do t'i regjistrojnë në regjistrin e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme(automjetet).

21. Taksa e rrugës Durrës –Kukës përbëhet nga:

a) mbitaksa për importet e taksueshme,

b) taksa mbi konsumin e karburantit,

c) taksa vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së.

Në zbatim të ligjit ngarkohen me llogaritjen dhe vjeljen e taksave:

Për mbitaksën e importeve të taksueshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet degëve të saj. Kjo taksë do të jetë në masën 1% të vlerës doganore dhe do të aplikohet mbi të gjitha mallrat e importit të taksueshme me taksë doganore duke filluar nga niveli 0.

Taksa mbi konsumin e karburantit është caktuar në masën 3 lekë për litër gazoil, benzine dhe benzol:

- për benzinën, benzolin dhe gazoilin e importuar taksa do të arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj në rrethe;

- për gazoilin, benzinën dhe benzolin e prodhuar në vend taksa do të arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të cilën ajo e vjel nëpërmjet prodhuesve të këtyre produkteve.

- për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar fillimisht do të aplikohet mbitaksa në masën 1% mbi vlerën doganore dhe në vijim taksa mbi konsumin e karburantit në masën 3 lekë për litër.

-Taksa vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së do të arkëtohet nga degët e tatimeve në rrethe për të gjithë subjektet e regjistruara në TVSH. Si taksë vjetore kjo do të arkëtohet brenda tremujorit të parë të vitit.

- Mbitaksa për importet e taksueshme dhe taksa mbi konsumin e karburantit për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar do të aplikohet në momentin e deklarimit të mallrave për t'u vendosur në qarkullim të lirë, ndërsa për gazoilin, benzinën, benzolin, të prodhuar në vend, në momentin e lëvizjes së këtyre produkteve nga vendi i prodhimit.

- Mbitaksa për importet e taksueshme dhe taksa mbi konsumin e karburantit për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar janë taksa ekstra, që nuk do të përfshihen në bazën e taksueshme për efekt të llogaritjes së taksës doganore, TVSH-së dhe akcizës.

- Mbitaksa për importet e taksueshme dhe taksa mbi konsumin e karburantit për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, nuk do të aplikohet për mallrat që vendosen në një nga regjimet doganore pezulluese, por do të aplikohet në momentin, kur mbyllja e regjimit përfundon me destinacionin e vendosjes në qarkullim të lirë.

Të ardhurat nga taksat kombëtare në zbatim të ligjit do të derdhen në llogaritë e buxhetit në një llogari të veçantë të emërtuar "Taksa e rrugës Durrës-Kukës".

22. Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin

-Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin është caktuar në masën 0.5 lekë për litër për benzinën, benzolin dhe 1 lekë për litër për gazoilin.

Për benzinën, benzolin dhe gazoilin e importuar ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj në rrethe. Taksa aplikohet në momentin e deklarimit të mallrave për t'u vendosur në qarkullim të lirë.

Për gazoilin, benzinën dhe benzolin e prodhuar në vend me vjeljen e taksës ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila e vjel këtë taksë tek prodhuesit e këtyre produkteve në momentin e lëvizjes së këtyre produkteve nga vendi i prodhimit.

Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe për gazoilin e importuar janë taksa ekstra, që nuk do të përfshihen në bazën e taksueshme për efekt të llogaritjes së taksës doganore, TVSH-së dhe akcizës.

Taksat e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin e importuar, nuk do të aplikohet për mallrat që vendosen në një nga regjimet doganore pezulluese, por do të aplikohet në momentin, kur mbyllja e regjimit përfundon me destinacionin e vendosjes në qarkullim të lirë.

23. Taksa për ambalazhet plastike të lëngjeve

Taksa e ambalazheve plastike të lëngjeve të importuar ose të prodhuar në vend llogaritet në masën 2 lekë për copë për ambalazhet e lëngjeve me kapacitet mbi 1.5 litra dhe 1 lekë për copë për ambalazhet me kapacitet 1.5 litra dhe më pak se 1.5 litra. Për mallrat e importuara kjo taksë arkëtohet nga Drejtoria Përgjithshme e Doganave nëpërmjet degëve të saj.

Taksat e ambalazheve plastike të lëngjeve janë taksa ekstra dhe nuk do të përfshihen në bazën e taksueshme për efekt të llogaritjes së taksës doganore, TVSH-së dhe akcizës.

Taksat për ambalazhet plastike të lëngjeve nuk do të aplikohen për mallrat që vendosen në një nga regjimet doganore pezulluese, por do të aplikohen në momentin, kur mbyllja e regjimit përfundon me destinacionin e vendosjes në qarkullim të lirë.

Për ambalazhet plastike të lëngjeve bosh që importohen, taksa nuk do të llogaritet në momentin e zhdoganimit të mallit, por tek prodhuesi i lëngjeve.

Për mallrat e prodhuara në vend dhe të ambalazuara me ambalazhe plastike vjelja e taksës bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet degëve të saj.

Prodhuesit për prodhimin e lëngjeve të ambalazuara në ambalazhe plastike bëjnë llogaritjen e taksës, të cilën e derdhin në llogarinë e tatimeve.

Degët e tatimeve në rrethe të evidentojnë subjektet që prodhojnë produktet e ambalazuara në ambalazhet plastike, të bëjnë kontrolle për llogaritjen korrekte të taksës dhe derdhen në afatet ligjore të saj.

Ky udhëzim hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002.

MINISTRI I FINANCAVE

KASTRIOT ISLAMI



Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Dega e Doganës

Nr.serial _____

V Ë R T E T I M

Vërtetojmë se Z. _____ banues në qytetin _____, shteti _____,
Nr.pasaporte _____ ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë sot më datën
_____ me automjetin _____ tip _____ me targë _____.

KRYETARI



Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Dega e Doganës
Nr.serial _____

V Ë R T E T I M

Vërtetojmë se Z. _____ banues në qytetin _____, shteti _____, me numër
pasaporte _____ ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë sot më datën _____ me
automjetin _____ tip _____ me targë _____. Mbi bazën e shkresës Nr. _____ datë _____ yë
degës së tatimeve ky mjet përjashtohet nga pagimi i taksës së qarkullimit të mjeteve të huaja.

KRYETARI

U D H Ë Z I M
Nr. 3, datë 27.1.2003

PËR TATIMIN E THJESHTUAR MBI FITIMIN

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të

nenit 32/2 pika 4 të ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime” në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 Për tatimin mbi të ardhurat, me ndryshimet përkatëse”, Ministri i Financave

U D H Ë Z O N:

1. Objekti i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin zbatohet ndaj tatimpaguesve që nuk janë të regjistruar ose të detyruar me ligj për t’u regjistruar për TVSH-në. Nga ky tatim janë të përjashtuar tatimpaguesit ambulantë në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve, si dhe tatimpaguesit që kryejnë veprimtari në lidhje me transportin individual.

Përkufizimi “ambulant në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve” përfshin çdo person i cili nuk ka një vendndodhje fikse (të palëvizshme) biznesi dhe merret me shitjen e mallrave ose kryerjen e shërbimeve në mënyrë ambulante. Përkufizimi përfshin, por nuk është i kufizuar vetëm me tregtarët në rrugë, tezat e përkohshme për tregtim, marangozët, elektrikistët, muratorët, bojaxhinjtë, ilustraxhinjtë, hidraulikët, këpucëndreqësit etj., të cilët nuk kanë një vendndodhje fikse (të palëvizshme) biznesi.

2. Regjistrimi

2.1. Kërkesat për regjistrimin për herë të parë

Në rastin e regjistrimit për herë të parë, tatimpaguesi duhet t’u paraqesë organeve tatimore të dhenat dhe dokumentet e mëposhtme :

- Formularin “Kërkesë për regjistrim” sipas formatit të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të plotësuar me të gjithë të dhënat e kërkuara, si dhe të nënshkruar nga tatimpaguesi.

- Dokumentin e identifikimit (certifikatën personale me fotografi) të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

- Vendimin e gjykatës.

- Statutin dhe aktin e themelimit në rastin e regjistrimit të shoqërive.

- Vërtetim nga dega e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore.

- Aktin e pronësisë të vendndodhjeve të biznesit ose kontratat e qiramarrjes për vendndodhjet e biznesit.

- Të dhëna për qarkullimin e parashikuar për vitin vijues.

- Licencën teknike dhe profesionale për veprimtari ekonomike për të cilat kërkohet me ligj një gjë e tillë.

2.2. Kërkesat për reregjistrim.

Në rastin e reregjistrimit, tatimpaguesi duhet të paraqesë në organet tatimore dokumentet dhe të dhënat e mëposhtme :

- Certifikatën tatimore të vitit të mëparshëm.

- Formularin “Kërkese për Regjistrim” sipas formatit të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të plotësuar me të gjithë të dhënat e kërkuara, si dhe të nënshkruar nga tatimpaguesi.

- Mandatpagesat për të gjitha detyrimet tatimore të vitit të kaluar.

- Deklaratë me shkrim për qarkullimin e realizuar në vitin e mëparshëm.

- Vërtetim nga dega e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për pagesën e kontributit të Sigurimeve Shoqërore.

- Librat e shitjes dhe të blerjes kur një gjë e tillë kërkohet nga administrata tatimore.

2.3. Certifikata e regjistrimit

Tatimpaguesit do të regjistrohen ose reregjistrohen në degën e tatimeve ku gjendet vendi kryesor i biznesit. Vendi kryesor i biznesit është vendndodhja e biznesit, e caktuar nga tatimpaguesi si vendi kryesor i veprimtarisë në kërkesën për regjistrim. Çdo ndryshim në vendin kryesor të biznesit, që është caktuar duhet të bëhet gjatë reregjistrimit ose duke dorëzuar një formular njoftim për ndryshime në të dhënat individuale.

Nëse nuk ka vendndodhje fikse të veprimtarisë, vendi kryesor i veprimtarisë do të jetë adresa e vendbanimit ose ajo e deklaruar nga vetë tatimpaguesi.

Çdo tatimpagues, pas përfundimit të procesit të regjistrimit, do të pajiset me një certifikatë

regjistrimi nga dega e tatimeve. Tatimpaguesit që janë regjistruar me detyrim, nuk do të pajisen me certifikatë regjistrimi deri sa të plotësojnë të gjithë kërkesat për regjistrim të parashikuara në nenin 32/2. Megjithatë, për qëllime evidentimi, kjo kategori do të konsiderohet si tatimpagues të regjistruar.

Kur tatimpaguesi ka më shumë se një vendndodhje biznesi, ai do të pajiset me certifikatë për çdo njëri nga këto vendndodhje. Në këtë rast certifikatat do të jenë me të njëjtin NIPT, por me numër serial të ndryshëm, të plotësuara me të dhënat e çdo vendndodhje të biznesit. Për qëllimet e nenit 32/2, pika (5) dhe çdo dispozite tjetër të këtij ligji nuk do të pranohet fotokopja e certifikatës së regjistrimit. Certifikata e regjistrimit është e detyrueshme të vendoset në një hapësirë të dukshme të vendndodhjes së biznesit, me qëllim identifikimin e regjistrimit të kësaj vendndodhjeje. Certifikata e regjistrimit është subjekt inspektimi nga organet tatimore.

2.4. Detyrimi për të njoftuar ndryshimet në të dhënat e regjistrimit apo reregjistrimit

Tatimpaguesi duhet të informojë degën e tatimeve për çdo ndryshim në të dhënat e paraqitura në momentin e regjistrimit duke përdorur formularin e kërkesës për regjistrim. Nëse tatimpaguesi ka një ndryshim në vendndodhje, që çon në një ndryshim në rrethin ku kryhet veprimtaria dhe njofton organin tatimor, ky i fundit, do të rilëshojë një formular për pagesë të zakonshme ku jepet adresa e re, ndërsa pagesa mund të bëhet në filialin e bankës ose zyrës së postës të gjendura në rrethin ku ndodhet vendndodhja e biznesit. Nëse ndryshimi nuk njoftohet, pagesa e tatimeve duhet të bëhet në përputhje me të dhënat e formularit për pagesë të zakonshme në bankë ose zyrën e postës së rrethit të regjistrimit.

3. Deklarimi

Tatimpaguesi duhet të deklarojë çdo vit qarkullimin e tij të përgjithshëm nga të gjithë bizneset brenda objektit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Deklarimi bëhet duke plotësuar formularin e kërkesës për regjistrim. Deklarata duhet të shoqërohet me librat e qarkullimit të mbajtur për çdo vendndodhje biznesi dhe librat e dorëzuara do të konsiderohen si pjesë e deklarimit të bërë.

Nëse tatimpaguesi ndërpret biznesin, ai duhet të paraqesë një deklaratë të qarkullimit të tij për vitin në vazhdim deri në datën e mbylljes në formularin e njoftimit të ndryshimeve në të dhënat e regjistrimit, i cili jep të gjitha të dhënat e kërkuara.

4. Mbajtja e regjistrimeve

Për çdo vendndodhje të veprimtarisë, tatimpaguesi duhet të mbajë një seri regjistrimesh më vete. Regjistrimet duhet të ruhen për 5 vjet nga fundi i vitit kalendarik të cilit i përkasin.

Për qëllimet e këtij tatimi, tatimpaguesi duhet të mbajë regjistrime për qarkullimin ditor dhe për shpenzimet ditore në librin përkatës të lidhur me faqe të numëruara. Libri duhet të paraqesë në mënyrë që të identifikohen qartë të dhënat e mëposhtme:

- numrat rendorë të dokumenteve të shitjes të lëshuara gjatë ditës,
- qarkullimi gjithsej për çdo ditë,
- qarkullimi progresiv nga fillimi i vitit kalendarik,
- blerjet ditore gjithsej të mallrave dhe materialeve,
- shpenzimet ditore të paguara për qëllimet e veprimtarisë.

Libri i shitjeve dhe i blerjeve do të jetë sipas formatit të treguar në shtojcën A bashkëngjitur këtij udhëzimi. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve mund të miratojë sisteme të tjera regjistrimi, të cilat plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj, por që përdorin sisteme të tjera për ruajtjen e të dhënave (p.sh. regjistrime kontabël të informatizuara).

Tatimpaguesi detyrohet të ruajë kuponat e arkës, kopje të dëftesave dhe faturave tatimore të lëshuara për klientët.

5. Lëshimi i dokumenteve të shitjes

Tatimpaguesit e biznesit të vogël janë të detyruar të lëshojnë dokumentet e mëposhtme për çdo shitje që realizojnë:

- Kupon tatimor në rastin kur tatimpaguesi është i pajisur me arkë regjistruese. Ky kupon i jepet klientit për çdo shitje të kryer.

- Dëftese tatimore në rastin kur tatimpaguesi nuk është pajisur me arkë regjistruese. Dëftesat tatimore përgatiten në dy kopje me letër vetëkopjuese nga të cilat njëra i jepet klientit.

- Faturë të thjeshtë tatimore e cila lëshohet vetëm nga tatimpaguesit, të cilët shesin mallra apo shërbime për klientë të cilët nuk janë konsumatorë finalë të mallit apo shërbimit, por i kryejnë këto blerje për qëllim përpunimi apo rishitje, pra janë subjekte të regjistruara për tatimet. Tatimpaguesi

duhet t'i japë klientit një faturë për çdo shitje mallrash apo shërbimesh. Fatura do të përbëhet nga dy kopje duke përdorur letër vetëkopjuese ose letër karbon dhe tatimpaguesi do t'ia japë një kopje klientit dhe një kopje do ta mbajë vetë. Fatura duhet të jetë me numër serial dhe numri i faturës duhet të shënohet në librin e shitjeve dhe blerjeve.

Dega e tatimeve mundet që në çdo kohë, të kontrollojë nëse tatimpaguesi lëshon dokumentet e shitjes, siç përcaktohet në ligj dhe në këtë udhëzim.

6. Kontrolli tatimor dhe verifikimi

Libri i shitjeve dhe blerjeve duhet të paraqitet në degën e tatimeve në momentin e regjistrimit dhe reregjistrimit. Dega e tatimeve verifikon librin e shitjeve dhe blerjeve për të parë nëse ai është mbajtur konform kërkesave të ligjit. Gjatë çdo kontrolli ose verifikimi të mëtejshëm, dega e tatimeve verifikon nëse tatimpaguesi e përdor rregullisht librin e shitjeve dhe blerjeve, duke zbatuar dënimet administrative në rastet e shkeljeve. Shkelje konsiderohet gjithashtu edhe mospërdorimi i librit.

7. Pagesa

7.1. Llogaritja e kësteve të pagesës

Në vitin e regjistrimit të parë, tatimpaguesi duhet të bëjë një parashikim të qarkullimit të tij për të gjithë vendndodhjet e regjistruara. Administrata tatimore llogarit këstet e tatimit në bazë të qarkullimit të parashikuar, përveç rasteve kur ekzistojnë të dhëna që tregojnë se parashikimi i bërë nga tatimpaguesi është i pasaktë, situatë në të cilën administrata tatimore mund të përdorë të dhënat që disponon për të rivlerësuar shifrën e qarkullimit të dhënë nga tatimpaguesi dhe të llogarisë këstet në bazë të shifrave të rivlerësuar.

Vitin në vijim të vitit të parë të regjistrimit, për qëllimet e përlllogaritjes së kesteve, administrata tatimore merr për bazë qarkullimin e realizuar vitin e mëparshëm. Në rastet kur tatimpaguesi ka kryer veprimtari vetëm një pjesë të vitit (disa muaj) të mëparshëm, për të llogaritur qarkullimin për vitin vijues do përdoret formula e mëposhtme :

$$12/n \times \text{qarkullimin e deklaruar (ku n është numri i muajve të pjesshëm ose të plotë për të cilët është ka patur qarkullim).}$$

Gjatë vitit, organet tatimore kontrollojnë rregullshmërinë e regjistrimeve të kërkuara ligjore për tatimpaguesit. Për këtë qëllim ato kontrollojnë: lëshimin e kuponit tatimor, të dëftesës tatimore ose faturës së thjeshtë, si dhe regjistrimin e çdonjërit prej këtyre dokumenteve në ditarin e qarkullimit. Ato kontrollojnë gjithashtu edhe evidentimin dhe regjistrimin nga tatimpaguesit të blerjeve (nëpërmjet dokumentacionit përkatës) të realizuara për qëllimet e biznesit (rishitje, përpunim apo shpenzime të tjera).

Krahas kontrollit të dokumentacionit, punonjësit e kontrollit të organeve tatimore bëjnë jo me pak se 2-3 kontrole (sondazhe për matjen e xhiros) në vit për çdo tatimpagues, me qëllim vlerësimin e qarkullimit të realizuar nga tatimpaguesi nëpërmjet kronometrit. Të dhënat e grumbulluara nga kronometrimet shërbejnë për vlerësimin e detyrimeve tatimore si të vitit vijues, ashtu edhe të vitit pasardhës. Për saktësimin e të dhënave të tatimpaguesve, organet tatimore shfrytëzojnë edhe burime të tjera informacioni, me të cilët tatimpaguesi ka operuar (si të dhënat e veprimeve me thesarin, të dhëna nga shkëmbimi i informacionit, të dhëna nga zërbërthimi i shitjeve të tatimpaguesve të mëdhenj importues apo prodhues etj). Mbi bazën e regjistrimeve korrekte të mbajtura gjatë gjithë vitit, dhe vlerësimeve nga kontrolli dhe organit tatimore, tatimpaguesit llogarisin dhe derdhin tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, sipas afateve të përcaktuara në ligj .

Kur ekzistojnë të dhëna që tregojnë se deklarimi i bërë nga tatimpaguesi është i pasaktë, administrata tatimore përdor gjithashtu të dhënat e ndryshme që disponon për të rivlerësuar shifrën e qarkullimit të dhënë nga tatimpaguesi dhe të llogarisë këstet në bazë të shifrave të rivlerësuar.

Lidhur me llogaritjen e kësteve të pagesës së detyrimeve, në shtojcën B jepet një shembull ilustrues.

Po në shtojcën B jepet dhe një shembull ilustrues për shumat dhe afatet e pagesës së kësteve.

7.2. Vlerësimi i detyrimeve tatimore shtesë

Kur vlerësohen detyrimet tatimore shtesë, organet tatimore mund të përdorin metoda alternative vlerësimi të parashikuara në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin në zbatim të tij.

Organet tatimore, për rastet kur konstatojnë se dokumentacioni i blerjeve dhe shitjeve nuk është mbajtur konform kërkesave ligjore, që do të thotë se tatimpaguesi nuk pasqyron në mënyrë korrekte xhiron, nuk lëshon në mënyrë korrekte dokumentin e kërkuar për çdo shitje, nuk pasqyron në

librat e blerjes të gjitha furnizimet që ka kryer, etj, kanë të drejtë të përdorin metodat alternative të vlerësimit të detyrimit tatimor. Metodatat alternative të vlerësimit janë sqaruar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe në udhëzimin përkatës të tij. Gjithashtu këto metoda do të përdoren edhe në rastet kur tatimpaguesit nuk deklarojnë të ardhurat e realizuara. Këto metoda do të përfshijnë (por pa u kufizuar vetëm në to) sondazhet dhe fotografimet e kryera lidhur me xhiron, sipërfaqet e prodhimit apo të shërbimit që disponon tatimpaguesi, pozicioni i vendit të biznesit (qendër apo periferi) detyrimet e llogaritura nga tatimpagues të rregullt, por që kanë afërsisht të njëjtat kushte biznesi, sikurse tatimpaguesi të cilit i bëhet vlerësimi etj.

7.3. Mënyra e pagesës.

Pagesa bëhet duke përdorur formularin e pagesës së zakonshme. Përpara pagesës, në formular duhet të vendoset NIPT-i i tatimpaguesit. Tatimi paguhet në një bankë ose zyrë postare, e cila vepron si agjente për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Pagesa bëhet në datën e duhur ose përpara saj në një bankë ose zyrë postare, që ndodhet në rrethin ku është regjistruar tatimpaguesi. Pagesa e pjesshme apo parapagesa për të cilën nuk identifikohet tatimpaguesi duke iu referuar NIPT-it nuk do të pranohet ose, nëse pranohet nga banka apo zyra postare që vepron si agjent për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nuk do të konsiderohet si pagesë kundrejt atij detyrimi të tatimpaguesit derisa të identifikohet pozitivisht nga organi tatimor se cili është tatimpaguesi që ka bërë pagesën. Nëse ky identifikim bëhet pas datës kur duhet të kryhej pagesa e tatimit, tatimpaguesi do të gjobitet sikur tatimi të ishte paguar në bankë apo zyrën postare në datën e identifikimit.

7.4. Akordimi i të ardhurave

Tatimi i mbledhur derdhet në Buxhetin e Shtetit për t’u transferuar eventalisht në buxhetet e çdo bashkie apo komune ku tatimpaguesi ka vendndodhjen e veprimtarisë në përpjestim me qarkullimin e realizuar nga kjo vendndodhje.

Organi tatimor pajis degën e tatimeve të bashkisë ose komunës me një listë të certifikatave të regjistrimit të lëshuara për vendndodhjet e biznesit brenda juridiksionit të tyre. Kjo listë identifikon qartë emrin dhe NIPT-in e tatimpaguesit, adresën e vendndodhjes së biznesit dhe shumën e tatimit të paguar.

Punonjësit e zyrës së tatimeve të bashkisë ose komunës duhet të përdorin këtë informacion për të informuar degën përkatëse të Tatimeve për çdo biznes të njohur, i cili nuk është pajisur me certifikatë regjistrimi.

Kur merr informacione nga bashkia apo komuna për biznese, të cilat nuk janë të pajisura me certifikatë regjistrimi, dega e tatimeve merr masa për t’i regjistruar ato biznese brenda 30 ditësh pas marrjes së informacionit dhe informon bashkinë apo komunën për masat e marra brenda 45 ditësh pas marrjes së informacionit.

7.5. Zbritja e detyrimit për regjistrim të hershëm

Kur tatimpaguesi e regjistron biznesin e tij përpara datës së përcaktuar në ligj, zbatohet menjëherë një zbritje, duke e zvogëluar pagesën e plotë të tatimit të parashikuar në nenin 32/3 të ligjit. Zbritja zbatohet mbi vlerën e detyrimit të subjektit për pagesën e kështit të parë të tatimit për vitin në të cilin është bërë zbritja.

7.6. Rimbursimi i tatimit të paguar më tepër

Çdo kërkesë për rimbursim nga ana e tatimpaguesit bëhet duke përdorur formularin e kërkesës për rimbursim dhe paguhet me marrjen e kërkesës dhe pas të gjithë verifikimeve të nevojshme, duke i transferuar në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I FINANCAVE
KASTRIOT ISLAMI**

Shtojca A. Format i tip i ditarit të qarkullimit

Faqe.....

Muaji

Nr.	Data	Numrat e dokumenteve	Qarkullimi	Qarkullimi	Blerje	Shpenzime	Shënime
-----	------	----------------------	------------	------------	--------	-----------	---------

		të lëshuara	ditor	progresiv		të tjera	
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							
12							
13							
14							
15							
16							
17							
18							
19							
20							
21							
22							
23							
24							
25							
26							
27							
28							
29							

Shtojca B. Shembuj për ilustrim

1. Llogaritja e qarkullimit të parashikuar sipas nenit 32/6

Tatimpaguesi regjistrohet për të parën herë më 1 korrik 2003. Ai parashikon se qarkullimi i tij për periudhën 1 korrik deri më 31 dhjetor 2003 do të jetë 2.500.000 lekë. Parapagimet për 2003-shin mbështeten mbi qarkullimin e parashikuar prej 2,500.000 lekësh (përveç rastit kur saktësohet nga dega tatimore mbështetur në fakte që flasin për qarkullim më të lartë).

Në mars 2004 ai dorëzon deklaratën e tij ku shihet se qarkullimi i tij faktik për periudhën 1 Korrik deri 31 dhjetor 2003 ishte 3.000.000 lekë. Parapagesat e tij për 2004 mbështeten në një qarkullim të parashikuar prej 6.000.000 (12/6 x 3.000.000).

Në mars 2005, ai dorëzon një deklaratë ku tregohet se qarkullimi i tij real për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2004 ishte 7.000.000. Qarkullimi i parashikuar për 2005 është qarkullimi i vitit të mëparshëm, d.m.th. 7.000.000

2. Llogaritja e parapagesave dhe pagesave të mbetura sipas nenit 32/6 (2) dhe (3) me dhe pa zbritje

Situata është e njëjtë me atë të shembullit 1.

Pagesat e tatimpaguesit për 2003 do të jenë:

Parapagesa 1 deri më 30 shtator 2003: $(2.500.000 \times 4\%) \times 25\% = 25.000$

Parapagesa 2 deri më 31 dhjetor 2003: $(2.500.000 \times 4\%) \times 50\% = 50.000$

Pagesa e mbetur për 2003 deri më 31 mars 2004: $(3.000.000 \times 4\%) - (25.000 + 50.000) = 45.000$

Parapagesat e tij për 2004 do të jenë:

Parapagesa 1 deri më 31 mars 2004: $(6.000.000 \times 4\%) \times 25\% = 60.000$

Parapagesa 2 deri më 30 shtator 2004: $(6.000.000 \times 4\%) \times 50\% = 120.000$
Pagesa e mbetur për 2004 deri më 31 mars 2005: $(7.000.000 \times 4\%) - (60.000 + 120.000) = 100.000$

(Nëse regjistrimi është plotësuar më 31 janar 2004 pagesa e mbetur do të zvoglohet me 2% të shumës së plotë: $280.000 \times 2\% = 5.600$ dhe pagesa e mbetur do të jetë 94.400)

Parapagesat e tij për 2005 do të jenë:

Parapagesa 1 deri më 31 mars 2005: $(7.000.000 \times 4\%) \times 25\% = 70.000$

Parapagesa 2 deri më 30 shtator 2005: $(7.000.000 \times 4\%) \times 50\% = 140.000$

3. Llogaritja e detyrimit tatimor në mbyllje të veprimtarisë sipas nenit 38 (5)

Në mars 2005, një tatimpagues dorëzon një deklaratë ku tregohet se qarkullimi i tij faktik për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2004 ishte 2.000.000. Prandaj, parapagesat e tij për 2005 janë:

Parapagesa 1 deri më 31 mars 2005: $(2.000.000 \times 4\%) \times 25\% = 20.000$

Parapagesa 2 deri më 30 shtator 2005: $(2.000.000 \times 4\%) \times 50\% = 40.000$

Situata (a)

Tatimpaguesi e ndërpret veprimtarinë më 30 qershor 2005, kur ka bërë parapagesën e parë në mars. Ai dorëzon një deklaratë ku tregon se qarkullimi i tij për periudhën 1 Janar 2005 deri më 30 Qershor 2005 ishte 8 000 000.

Detyrimi i pashlyer për 2005 është $(8\,000\,000 \times 4\%) - 20.000 = 120.000$

Ai duhet të paguajë edhe 12.000 brenda 15 ditësh nga mbyllja e veprimtarisë.

Situata (b)

Tatimpaguesi ndërpret veprimtarinë më 31 tetor, pasi ka bërë të dy parapagesat. Ai dorëzon një deklaratë ku tregon se qarkullimi i tij për periudhën 1 janar deri më 31 tetor 2005 do të jetë 1.200.000.

Detyrimi i tij i pashlyer për 2005 është $(1.200.000 \times 4\%) - 60.000 = (12.000)$ rimbursim

Dega tatimore duhet të përdorë pagesën e tepërt prej 12.000 për të shlyrë detyrime të tjera ose do ta rimbursojë atë brenda 30 ditësh nga marrja e deklaratës së mbylljes.

U D H Ë Z I M

Nr. 4, datë 27.1.2003

PËR TAKSËN VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 3, pika 4 dhe neneve 5, 6, 7, 8 të ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore mbi biznesin e vogël”, Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

U D H Ë Z O J N Ë:

1. Të përgjithshme

Taksa vendore mbi biznesin e vogel administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Të gjitha referimet në ligjin Nr. 8978, date 12.12.2002 “Per Taksen Vendore mbi Biznesin e Vogel” për “organin tatimor” nënkuptojnë degën e tatimeve të rrethit përkatës.

Për qëllimet e këtij ligji, një njoftim i lëshuar nga dega e tatimeve në rreth apo nga Komisioni i Apelimit të Tatimeve, konsiderohet i marrë :

në datën kur njoftimi është dërguar dorazi në ambientet e biznesit ose të banimit të tatimpaguesit; ose

7 ditë nga data në të cilën njoftimi është postuar.

2. Niveli i taksës vendore mbi biznesin e vogël

2.1. Niveli tregues i taksës

Nivelet treguese të taksës vendore mbi biznesin e vogel, të dhëna në tabelën 1 të ligjit janë nivele orientuese. Shuma faktike e tatimit për t'u paguar për çdo kategori biznesi përcaktohet nga organi legjislativ (këshilli) i bashkisë ose komunës në të cilën ndodhet biznesi. Këshilli i Bashkisë ose komunës mund të ndryshojë nivelin orientues të taksës të përcaktuar në tabelën 1, duke e rritur ose

ulur atë deri në 30%. Kështu për shembull, nëse niveli orientues i taksës është 100.000 lekë, niveli faktik mund të vendoset ndërmjet 70.000 dhe 130.000 lekë. Por nëse vendoset të ndryshohen nivelet orientuese të taksës, ndryshimi përfshin të gjithë nivelet në tabelën 1, me të njëjtën përqindje. Në qoftë se për shembull, këshilli i bashkisë ose i komunës vendos të rrisë nivelin tregues të taksës vendore mbi biznesin e vogël me 20 përqind, ky ndryshim është i njëjtë, papërrjashtim, për të gjithë kategoritë e bizneseve që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin territorial të bashkisë apo të komunës përkatëse.

2.2. Publikimi i nivelit të taksës

Organi legjislativ (këshilli) i bashkisë ose komunës duhet të informojë tatimpaguesit e rrethit në të cilin zbatohen nivelet e takses për vitin kalendarik, jo më vonë se data 15 dhjetor e vitit pararendës, duke i botuar ato në gazetatat e mediave lokale, duke vendosur afishe në ndërtesa të vende publike dhe duke i dërguar me shkrim Degës së Tatimeve të rrethit përkatës, nivelet e taksave që do të zbatohen. Nëse bashkia apo komuna nuk e bën një gjë të tillë, Dega e Tatimeve në rreth do të zbatojë nivelet orientuese të taksës së përcaktuar në tabelën 1 të ligjit. Pasi të jenë botuar, nivelet e taksave të vitit nuk mund të ndryshohen gjatë vitit.

Për vitin 2003, nivelet orientuese të taksës të përcaktuara në tabelën 1 të ligjit, nuk mund të ndryshohen.

2.3. Fillimi dhe mbyllja e biznesit

Nëse biznesi fillon apo pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën me kuotë fikse për vitin e plotë kalendarik, me numrin e muajve të plotë apo të pjesshëm gjatë të cilëve veprimtaria është kryer ose do të kryhet (përfshi muajin e regjistrimit në rastet kur biznesi fillon për herë të parë) dhe duke e pjesëtuar atë me 12.

Kështu për shembull :

- nëse biznesi e fillon veprimtarinë më 15 prill, detyrimi i tij tatimor do të jetë i barabartë me 9/12 e shumës për t'u paguar për vitin.

- nëse biznesi pushon veprimtarinë më 15 prill, detyrimi i tij tatimor do të jetë i barabartë me 4/12 e shumës për t'u paguar për vitin.

Llogaritja si më sipër për zbritjen e detyrimit tatimor të tatimpaguesit, bëhet vetëm pasi tatimpaguesi i regjistruar të ketë dorëzuar certifikatën e tij të regjistrimit në degën e tatimeve të rrethit ku është regjistruar.

2.4. Ndërprerja e veprimtarisë së biznesit

a. Nëse biznesi ndërpritet përkohësisht gjatë vitit, detyrimi tatimor për atë vit llogaritet duke shumëzuar shumën fikse të tatimit për të gjithë vitin kalendarik, me numrin e muajve të pjesshëm apo të plotë gjatë të cilëve është kryer biznesi dhe duke i pjesëtuar më pas me 12. Për shembull:

- Nëse biznesi ndërpritet më 15 prill dhe rifillon më 25 maj, detyrimi tatimor do të jetë 12/12 të vlefshëm së detyrimit për vitin. Pra, tatimpaguesi në këtë rast nuk do të përfitojë zbritje, pasi ai nuk ka ndërprerë veprimtarinë për më shumë se një muaj të plotë kalendarik.

- Nëse biznesi ndërpritet më 15 prill dhe rifillon më 25 qershor, detyrimi tatimor do të jetë 11/12 të vlefshëm së detyrimit për vitin. Pra tatimpaguesi në këtë rast do të përfitojë zbritje të tatimit për një muaj, pasi ai ka ndërprerë veprimtarinë vetëm për një muaj të plotë kalendarik.

b. Tatimpaguesi i regjistruar nuk përfiton zbritje neqoftese ai nuk ka dorëzuar certifikatën e regjistrimit në degën përkatëse të tatimeve përpara ditës së parë të muajit të plotë të ndërprerjes së veprimtarisë. Dega përkatëse e tatimeve pajis tatimpaguesin me një procesverbal, që tregon datën e dorëzimit të certifikatës së regjistrimit dhe datën e kthimit të saj kur të rifillojë biznesi.

c. Periudha maksimale e lejueshme për ndërprerjen e veprimtarisë ekonomike është dy muaj për çdo vit kalendarik.

d. Zbritja për ndërprerjen e përkohshme të veprimtarisë, bëhet nga vlera gjithsej e tatimit për t'u paguar në vitin kalendarik vijues të regjistrimit, me kërkesë të tatimpaguesit dhe pas dorëzimit të provave për ndërprerjen e veprimtarisë duke paraqitur procesverbalin e lëshuar nga dega përkatëse e tatimeve.

3. Përcaktimi i vendndodhjes së biznesit

3.1. Vendndodhja e biznesit

Tatimpaguesi i kërkohet të paguajë taksën vendore mbi biznesin e vogël për çdo vendndodhje biznesi në përputhje me nivelin tatimor të përcaktuar për llojin e biznesit dhe kategorinë e zonës gjeografike ku ai është regjistruar. Bizneset e ndryshme nën administrimin e tatimpaguesve të ndryshëm që ushtrojnë veprimtari në një vendndodhje (në një godinë) do të taten gjithnjë si

vendndodhje biznesi më vete.

Një “vendndodhje biznesi” është një zonë e dallueshme dhe e ndarë si në të njëjtën godinë ashtu edhe në godina të ndryshme. Për shembull :

a. Kur veprimtari të ndryshme ekonomike kryhen nga një tatimpagues në të njëjtën dhomë konsiderohen si një vendndodhje e një biznesi.

b. E njëjta veprimtari ekonomike e kryer nga një tatimpagues në dy dhoma, që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen një biznes, pra konsiderohen si një “vendndodhje biznesi”.

c. Dy veprimtari të ndryshme ekonomike të kryera nga një tatimpagues në dy dhoma, që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si dy “vendndodhje biznesi”.

d. Disa veprimtari ekonomike të ndryshme ose e njëjta veprimtari ekonomike e kryer në dy dhoma fqinje, që nuk komunikojnë me njëra tjetrën nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si dy “vendndodhje biznesi”.

3.2. Ndryshimi i vendndodhjes së biznesit

Tatimpaguesi është i detyruar të paguajë taksën vendore mbi biznesin e vogël për çdo vendndodhje biznesi sipas nivelit tatimor në fuqi në kohën e regjistrimit. Deri në momentin e reregjistrimit në vitin e ardhshëm pas ndryshimit të vendndodhjes, nuk do të ketë rritje apo zbritje të detyrimit tatimor.

3.3. Kategorizimi i veprimtarive për efekt të taksës vendore mbi biznesin e vogël

Në grupin “shitje me pakicë” përfshihen të gjitha pikat fikse (dyqanet, njësitë, barakat etj.), të tregtimit të mallrave të ndryshme me pakicë. Po këtu përfshihen dyqanet e veshjeve, dyqanet e modës, të luksit (boutique), parfumeritë, dyqanet që tregtojnë bizhuteri argjendi, floriri e materiale të tjera të çmuara. Gjithashtu në grupin “shitje me pakicë” hyjnë edhe njësitë e ushqimit social si: restorante, fast-food, bar-bufe, disko, kafe-internet, pub e të tjera të ngjashme me to.

Në grupin “shitje me shumicë” përfshihen të gjitha pikat fikse (magazina, dyqane etj.) të cilat realizojnë shitje me shumicë të artikujve që tregtojnë. Do të konsiderohen shitje me shumicë, shitjet që bëhen për tatimpagues të tjerë me qëllim rishitjen e mallrave. Nëse një njësi realizon njëkohësisht shitje të mallrave me shumicë, të cilat blihen nga tatimpagues të tjerë me qëllim rishitjeje, si dhe shitje me pakicë për konsumatorët, kjo njësi do të klasifikohet në grupin “shitje me shumicë”.

Në grupin “prodhim” përfshihen tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari prodhimi, përpunimi dhe tregtimi, si: përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje etj, të ngjashme me to. Po këtu përfshihen prodhimet me karakter ushqimor si: prodhime buke, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, etj, të ngjashme me to.

Në grupin “shërbime” përfshihen veprimtari të tilla si: riparimi i artikujve elektroshtëpiakë, radio televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofon, pajisje fonie e të tjera të ngjashme me to. Po kështu klasifikohen në këtë grup veprimtaritë e shërbimit të fotokopjimit, sallon bukurie, autoservisë, kurse për makina (autoshkolla) për traktorë, për kompjuter e për parukeri, agjenci doganore, agjenci këmbimi valute, agjenci turizmi, motele, pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkimi i makinave, lavanteritë, pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojërave të ndryshme (gjimnastikë, aerobie, cirqe, kënde lojrash për fëmijë, pingpong, etj.) e të tjera shërbime të ngjashme me shërbimet e lartpërmendura.

Në grupin “profesione të lira” përfshihen tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë e avokatit, noterit, mjekut, mjekut-laborant, stomatologut, farmacistit, ekonomistit kontabël të miratuar, ekspertit kontabël të autorizuar, mësuesit, veterinerit, agronomit, botuesit, inxhinierit, arkitektit, projektuesit e të tjera profesione të lira, të cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme. Në këtë grup përfshihen edhe galeritë e artit të piktorëve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë, që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike. Po kështu në këtë grup përfshihen institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet) shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostikimi etj., në rastet kur nuk e kalojnë kufirin e regjistrimit në TVSH.

4. Kërkesat për regjistrim

Tatimpaguesi duhet të regjistrojë çdo vendndodhje të biznesit në degën përkatëse të tatimeve në të cilin ndodhet. Nëse tatimpaguesi ka biznese në territore jashtë juridiksionit të degës përkatëse të tatimeve, ai duhet t’i regjistrojë të gjithë vendndodhjet e biznesit të tij në degën e tatimeve në të cilin gjendet vendi kryesor i biznesit. Vendi kryesor i biznesit caktohet nga tatimpaguesi.

Kërkesa për regjistrim ose reregjistrim duhet të bëhet duke përdorur formularin Kërkesë për Regjistrim të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

4.1. Në rastin e regjistrimit për herë të parë.

Kur një tatimpagues regjistrohet për herë të parë ai duhet të paraqesë sa më poshtë:

a. Një kërkesë për t'u regjistruar ku të jepet emri dhe adresa e tatimpaguesit, adresa e vendndodhjes (eve) së biznesit dhe tipin e biznesit (eve) që do të kryhen në atë (ato) vendndodhje të biznesit.

b. Dokumentin e identifikimit (certifikaten personale me fotografi të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

c. Vendimin e gjykatës.

d. Mandatpagesën për këstin e parë të detyrimit tatimor.

e. Vërtetim nga pushteti vendor për pagesën e taksave dhe tarifave vendore.

f. Vërtetim nga dega e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

g. Çdo dokument ose kërkesë tjetër e specifikuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe që i bëhet e ditur tatimpaguesit në momentin e depozitimit të kërkesës për regjistrim.

Nëse tatimpaguesi nuk ka qenë i pajisur më parë me një NIPT, Dega e Tatimeve do ta pajisë me NIPT-in në momentin e regjistrimit.

4.2. Në rastin e reregjistrimit të përvitshëm .

Kur një tatimpagues bën reregjistrimin e përvitshëm, ai duhet të paraqesë sa më poshtë:

a. Një kërkesë për t'u regjistruar, që të përmbajë emrin dhe adresën e tatimpaguesit, adresën e vendndodhjes (eve) të biznesit dhe tipin e biznesit (eve) që kryhen në vendndodhjen (et) e biznesit.

b. Certifikatën e vitit të mëparshëm.

c. Mandatpagesën e kështit të parë të detyrimit tatimor të vitit vijues.

d. Vërtetim nga dega e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

e. Vërtetim nga pushteti vendor për pagesën e taksave dhe tarifave vendore.

f. Çdo dokument apo kërkesë tjetër e specifikuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe që i bëhet e ditur tatimpaguesit në momentin e depozitimit të kërkesës për regjistrim

4.3. Pajisja me Certifikatë regjistrimi.

Dega përkatese e tatimeve do të pajisë me Certifikatë regjistrimi çdo tatimpagues që përmbush të gjitha kërkesat e mësipërme. Një tatimpagues që është regjistruar me detyrim nuk do të pajiset me Certifikatë, deri sa ai të ketë përmbushur të gjithë kërkesat.

Certifikata e regjistrimit përmban emrin e tatimpaguesit, numrin e identifikimit të tatimpaguesit që i është caktuar atij, numrin e vendimit të gjykatës, adresën e vendndodhjes së biznesit me të cilin lidhet dhe periudhën kohore për të cilën është e vlefshme kjo Certifikatë. Certifikata e regjistrimit është e detyrueshme të vendoset në një hapësirë të dukshme të vendndodhjes së biznesit, me qëllim identifikimin e regjistrimit të kësaj vendndodhje. Certifikata e regjistrimit është subjekt inspektimi nga organet vendore ose kombëtare.

Degët përkatëse të tatimeve, u japin organeve tatimore të bashkive dhe komunave listën e certifikatave të lëshuara për vendndodhjet e bizneseve brenda juridiksionit të tyre. Inspektorët e bashkive dhe komunave mund t'a përdorin informacionin për qëllime verifikimi dhe janë të detyruar të informojnë degën përkatëse të tatimeve lidhur me çdo subjekt për të cilin janë në dijeni se nuk është i pajisur me certifikatë regjistrimi.

5. Pagesa

Pagesat duhet të bëhen duke përdorur formularin e pagesës së zakonshme, lëshuar nga organi tatimor dhe vlefëta e pagesës duhet të jetë e barabartë me shumën e treguar në formularin e pagesës. Formulari duhet të tregojë NIPT-in e tatimpaguesit që bën pagesën, identitetin e tij, adresën e vendndodhjes së biznesit, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar në këtë formular.

Tatimi mund të paguhet në një dege banke ose zyrë postare, e cila vepron në rolin e agjentit të organit tatimor. Pagesa e detyrimeve bëhet në datën e duhur ose përpara saj, në një dege banke ose zyrë postare, që ndodhen në territorin përkatës ku është i regjistruar tatimpaguesi.

Çdo rimbursim që i duhet bërë tatimpaguesit, kërkohet nga ana e tij nëpërmjet formularit të kërkesës për rimbursim, dhe paguhet pas marrjes së kërkesës, pasi të jenë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme.

6. Apelimet

Apelimi bëhet me shkrim dhe ai përmban :

a) emrin, adresën dhe NIPT-in e apeluesit;

- b) vitin tatimor me të cilin lidhet apelimi;
- c) natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi;
- d) baza ku mbështetet apelimi.

Procedurat e apelimit dhe procedurat e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në ligjin “Për procedurat tatimore” dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të tij.

MINISTRI I FINANCEVE
KASTRIOT ISLAMI

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT
BEN BLUSHI

U D H Ë Z I M

Nr. 5, datë 27.01.2003

MBI BASHKËPUNIMIN NDËRMJET ORGANEVE TATIMORE QENDRORE DHE ORGANEVE TË PUSHTETIT VENDOR LIDHUR ME ADMINISTRIMIN E TAKSËS VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL DHE TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN

Në zbatim të pikës 4 të nenit 3, nenit 8 të ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, të nenit 5 dhe pikës 7 të nenit 32/6 të ligjit nr.8979, datë 12.12.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për tatimin mbi të ardhurat Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

U D H Ë Z O J N Ë :

1. Të përgjithshme

Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, organet tatimore qendrore (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj në rrethe) dhe organet e pushtetit vendor do të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për një zbatim sa më efektiv të ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për tatimin mbi të ardhurat”, kapitulli iii/a, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe të ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002 “Per taksën vendore për biznesin e vogël” dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tyre.

Në varësi të ecurisë së zbatimit të këtyre ligjeve dhe udhëzimeve dhe problemeve që do të dalin, kur është e nevojshme, këto institucione do të bashkëpunojnë në fushat e interesit të përbashkët si :

- regjistrimi i tatimpaguesve;
- shkëmbimi periodik i informacionit mbi tatimpaguesit e regjistruar;
- shkëmbimi periodik i informacionit mbi realizimin e të ardhurave;
- planifikimi i të ardhurave nga njësitë vendore dhe organet tatimore;
- pagesat dhe transferimi i të ardhurave;
- bashkëpunimi mbi unifikimin e sistemit të regjistrimit të të dhënave mbi tatimpaguesit;
- identifikimi i tatimpaguesve të paregjistruar;
- kontrole të përbashkëta mbi regjistrimin;
- konsulenca të përbashkëta, shkëmbim eksperience, trajnime të ndryshme etj.

2.Mbajtja e regjistrave

Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i tatimpaguesve.

Në këtë regjistër do të regjistrohen të gjithë tatimpaguesit me të dhëna që lidhen me vendndodhjen e tatimpaguesve, llojin e aktivitetit, etj.

Zyrat e taksave të bashkive dhe komunave, me qëllim evidentimin sa më të saktë të tatimpaguesve, kur bëjnë regjistrimin në regjistër si më lart, duhet të përdorin numrin e identifikimit të regjistrimit pranë organeve tatimore (NIPT- i) dhe kodin vendor të bashkise ose komunës respektive.

Në kuptim të këtij udhëzimi kodi vendor është një numër identifikimi i bashkisë ose i komunës, i cili do të shërbejë për identifikimin e tatimpaguesve dhe të të ardhurave të realizuara prej tyre sipas bashkive dhe komunave respektive.

Kodi vendor përcaktohet nga Ministria e Financave dhe i njoftohet në mënyrë të unifikuar për zbatim, drejtorisë së përgjithshme të tatimeve, degëve të tatimeve në rrethe dhe çdo bashkie dhe komune.

Kodi vendor është sipas listës bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Për këtë qëllim, brenda datës 10, të çdo muaji, dega e tatimeve dërgon pranë çdo bashkie ose komune një listë të tatimpaguesve të regjistruar brenda juridiksionit të tyre gjatë muajit të mëparshëm. Kjo listë identifikon qartë emrin dhe NIPT-in e tatimpaguesit, adresën e vendndodhjes së biznesit dhe kodin vendor të bashkisë ose komunës.

3. Shkëmbimi periodik i informacionit

Shkëmbimi periodik i informacionit konsiston në:

- shkëmbimin periodik të informacionit mbi subjektet e regjistruara.

Degët e tatimeve në rrethe do t'u dërgojnë bashkive dhe komunave të rretheve respektive, çdo datë 10 të muajit pasardhës, një njoftim mbi listën e subjekteve të regjistruara si tatimpagues të biznesit të vogël, tipin e biznesit (kategorinë për efekt pagese).

Punonjësit e zyrave të taksave në bashki apo komuna si dhe ato të policive bashkiake, në asnjë rast nuk mund të bëjnë kontrolle mbi xhiron e tatimpaguesve të juridiksionit të tyre. Ato mund të bëjnë kontrolle vetëm lidhur me identifikimin e tatimpaguesve të paregjistruar dhe të tatimpaguesve që nuk kanë paguar në kohë detyrimet e tyre, duke informuar periodikisht me shkrim degën e tatimeve të rrethit përkatës.

Kur bashkitë dhe komunat konstatojnë dhe identifikojnë subjekte të paregjistruara, raste kur tatimpagues nuk janë kategorizuar në kategorinë përkatëse sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore, ndryshime në të dhënat e tatimpaguesit, mosrespektimin e dispozitave ligjore nga tatimpaguesit etj, dërgojnë për veprim pranë degëve të tatimeve në rrethe informacionin e mësipërm.

Degët e tatimeve përkatëse pas marrjes së informacioneve nga bashkia ose komuna për biznese të cilat nuk janë të pajisura me certifikatë regjistrimi, marrin masa për t'i regjistruar këto biznese brenda 30 ditëve pas marrjes së informacionit, dhe informojnë bashkinë ose komunën për masat e marra brenda 45 ditëve.

Në raste të veçanta informacioni verifikohet bashkërisht duke krijuar grupe të përbashkëta me përfaqësues të organeve tatimore dhe bashkive ose komunave.

- Shkëmbimin periodik të informacionit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave.

Degët e tatimeve në rrethe do t'u dërgojnë bashkive dhe komunave të rretheve respektive, çdo datë 10 të muajit pasardhës, informacion mbi shumën e arkëtuar të taksës vendore për biznesin e vogël dhe shumën e tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin.

Bashkitë dhe komunat brenda muajit korrik të vitit korrent, me vendim të këshillit vendor, përcaktojnë nivelin e taksës mbi biznesin e vogël për vitin pasardhës, dhe njoftojnë për këtë degën e tatimeve të rrethit përkatës.

Degët e tatimeve brenda muajit gusht të vitit, në bazë të numrit të subjekteve dhe kategorizimeve të tyre, kryejnë planifikimin e të ardhurave të vitit pasardhës dhe njoftojnë bashkitë dhe komunat brenda këtij afati për arsye të hartimit të projektbuxhetit nga ato.

4. Pagesa dhe transferimi i të ardhurave

Pagesa e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe e tatimit të thjeshtuar do të bëhet në llogarinë e degës përkatëse të tatimeve me ane të "formularit të pagesës". Ky formular përmban edhe kodin vendor të bashkisë ose komunës përkatëse, i cili shërben për ndarjen e të ardhurave për efekt të transfertës së tyre në buxhetin e bashkisë / komunës, ku është vendndodhja e biznesit të taksueshëm.

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin transferohet brenda datës 10 të muajit pasardhës në llogaritë e bashkive /komunave përkatëse.

Ky transferim bëhet nga dega e thesarit të rrethit përkatës, në bazë të listës totale të bashkive /komunave të dërguar nga dega e tatim taksave e rrethit brenda datës 10 të muajit pasardhës, për shumën e arkëtuar për çdo bashki/komune.

5. Kontrolli i përbashkët mbi regjistrimin dhe respektimin e dispozitave ligjore nga tatimpaguesit.

Punonjësit e degëve të tatimeve dhe zyrave të taksave nëpër bashki e komuna me miratimin e titullarëve respektivë mund të ndërmarrin aksione të përbashkëta për identifikimin dhe regjistrimin e bizneseve që rezultojnë të paregjistruara si dhe për respektimin e afateve ligjore të derdhjes së këtyre detyrimeve. Në këto grupe mund të marrin pjesë dhe policisë tatimore dhe ato bashkiake.

6. Konsulenca të përbashkëta, trajnime, etj.

Organet tatimore qendrore dhe vendore, mbi bazën e kërkesave reciproke, organizojnë takime të përbashkëta në kuadër të shkëmbimit të ekperiencës.

Organet tatimore qendrore ofrojnë asistencë teknike dhe trainime të ndryshme për organet tatimore vendore, me qëllim rritjen e kapaciteteve organizative dhe manaxhimit fiskal në drejtim të administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në përgjithësi dhe taksës mbi biznesin e vogël në veçanti.

7. Të tjera

Organet tatimore qendrore dhe vendore, përveç sa parashikohet në këtë udhëzim mund të trajtojnë në mënyrë më të detajuar çështje të interesit të përbashkët nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta që mund të lidhin për këtë qëllim.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
ISLAMI

KASTRIOT

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT
BEN BLUSHI

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 11.3.2003
Doli nga shtypi më 12.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë